



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:181811

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06522014

P.nr.2024:181811

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. B. nga Gjakova për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par 2 lidhur me par. 1 nën par 1.4 të KPRK-së, M. Ll. dhe M. Ll. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par. 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP.II.nr.651/22 të datës 09.07.2024 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 01.11.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Azem Islamaj, të akuzuarve A. B. me mbrojtësin e tij avokat Qemajl Juniku, i angazhuar sipas detyres zyrtare dhe të akuzuarve M. Ll. dhe M. Ll., me datë 06.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 27.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

A. B., data e lindjes . . . , në Gjakovë, me banim në Rr “. . . , në Gjakovë, nga i ati I dhe e ëma V, i pa martuar, i punësuar, ka te kryer 2 vite shkollës se mesme, i gjendjes së dobet ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal. . . . ,

M. LL., data e lindjes . . . , në Gjakovë, me banim në fshatin . . . , rr”. . . “p.nr, K. Gjakovë, nga i ati M dhe e ëma F, e vajzërisë K, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i pa pune, përfitues i asistencës sociale, i gjendjes së dobet ekonomike, ka te përfunduar shkollën fillore, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal. . .

dhe

M. LL., data e lindjes . . . , në Gjakovë, me banim në fshatin . . . “p.nr, Komuna e Gjakovës, nga i ati A dhe e ëma M, e vajzërisë D, i pa martuar, i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka te kryer 2 vite shkollës se mesme, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal. . . .

J A N Ë F A J T O R Ë

I akuzuari A. B.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 14.09.2021, rreth orës 21:50, në Gjakovë, me mjet që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të përkohshme të shëndetit dhe atë të dëmtuarit M. Ll., në atë mënyrë që, natën kritike, pasi i pandehuri takohet me të dëmtuarin dhe pas një fjalosje verbale fillon konfrontimi fizik mes tyre, me ç’ rast i pandehuri gjatë përleshjes fizike për një moment e nxjerr një mjet/brisk dhe me të e godet të dëmtuarin M. në pjesën e djathtë të këmbës, duke i’u shkaktuar lëndime trupore, të cilat lëndime në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore janë kualifikuar si dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet.

- Me këtë ka kryer veprë penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par.2, lidhur me par.1, nën par.1.4, të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46,48,49, 69,70 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Gjukata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryen një apo më shumë vepra penale.

- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar M. Ll. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akzuarit M. LL. dhe M. LL.

JANË FAJTORË

Sepse me datën 14.09.2021, rreth orës 21:50, në Gjakovë, duke vepruar si bashkëkryerës, tjetrit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të përkohshme të shëndetit dhe atë të dëmtuarit A. B., në atë mënyrë që, natën kritike, pas ngjarjes së përshkruar si me lartë, të pandehurit e godasin të dëmtuarin me grushte në pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore si: gërvishje të lëkurës në fytyrë dhe kokë, të cilat lëndime në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore janë kualifikuar si dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet.

- Me çka ne bashkëkryerje kanë kryer veprë penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, par. 1, nën par. 1.4, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46,48,49, 69,70 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, të akuzuarve ju shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcakohet:

- I. Të akzuarit M. Ll. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Të akzuarit M. Ll. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- III. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse të dënuarit gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryejnë një apo më shumë vepra penale.

- IV. I akuzuari M. Ll. lirohet nga obligimi i shpenzimeve procedurale, pasi që i njejtë është përfitues i ndihmës sociale.
- V. Obligohet i akuzuari M. Ll. që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën me numër PP/.II.nr.651/22 të datës 09.07.2024, kundër të akuzuarve A. B. nga Gjakova për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, M. Ll. dhe M. Ll. nga fshati . . . , për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njejtë të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm me datë 01.11.2024 ka mbajtur shqyrtimin fillestar për të akuzuarit A. B., M. Ll. dhe M. Ll., për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës së lartcekur, në të cilin shqyrtim ishin prezent Prokurori i Shtetit Azem Islamaj, i akuzuarit A. B. me mbrojtësin e tij avokat Qemajl Juniku dhe të akuzuarit M. Ll. dhe M. Ll..

I akuzuari A. B. në shqyrtim fillestar pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favorët dhe pasojat e pranimi të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, kërkoj falje për atë që ka ndodhur, nuk kemi pasur asnjëherë probleme, ka qenë mosmarrëveshje e çastit dhe nuk kemi më probleme edhe pas këtij rasti.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. B. avokat Qemajl Juniku lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se nga pohimet e të akuzuarve dhe dokumentacioni në lëndë na rezulton se në ditën kritike të akuzuarit kanë pasur një fjalosje dhe pastaj kanë rezultuar me sulme fizike të ndërsjellta. Në këtë kontest i mbrojturi im e pranon shkallën e fajësisë për veprën e kryer dhe para gjykatës edhe u deklarua se ky ka qenë sulmi i rastit dhe se nuk do të përsëritet në të ardhmen.

I akuzuari M. Ll. në shqyrtim fillestar pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favorët dhe pasojat e pranimi të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, dhe ja lë gjykatës në vlerësim.

I akuzuari M. Ll. në shqyrtim fillestar pas leximit të aktakuzes nga Prokurori i Shtetit deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës.

Prokurori i Shtetit Azem Islamaj lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtim fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë për të akuzuarin A. B. për pikën e I të dispozitivit meqenëse ky pranim i fajësisë u bë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet që rrjedhin nga pranimi i fajësisë si dhe faktin se ky pranim i fajësisë gjen mbështetje të plotë në provat që i janë bashkangjitur kësaj aktakuze, po ashtu nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë së këtu të pandehurve M. dhe M. L. lidhur me pikën e III të dispozitivit ku të njëjtit akuzohen se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të Lëndimit të lehtë trupor, meqenëse ky pranim i fajësisë së të njëjtëve është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas sqarimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet që rrjedhin nga pranimi i fajësisë si dhe faktin se ky pranim i fajësisë gjen mbështetje të plotë në provat që i janë bashkangjitur kësaj aktakuze, andaj gjykatës i propozoj që pranimi i fajësisë së të njëjtëve të aprovohet.

I dëmtuari M. Ll. lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari A. B. ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, ja lë në vlerësim gjykatës dhe kërkoj kompensim dëmi.

I dëmtuari A. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit M. dhe M. Ll. ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, ja lë në vlerësim gjykatës, nuk kërkoj kompensim dëmi.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i çështjes në shqyrtim fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A. B. nga Gjakova për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së dhe të akuzuarve M. Ll. dhe M. Ll. nga fshati Osek Hilë, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nga se ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së.

Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që ju vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë gjykata ka konsideruar se në këtë fazë të procedurës nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari A. B. nga Gjakova ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe menyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datën 14.09.2021, rreth orës 21:50, në Gjakovë, me mjet që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të përkohshme të shëndetit dhe atë të dëmtuarit M. Ll., në atë mënyrë që, natën kritike, pasi i pandehuri takohet me të dëmtuarin dhe pas një fjalosje verbale fillon konfrontimi fizik mes tyre, me ç' rast i pandehuri gjatë përleshjes fizike për një moment e nxjerr një mjet/brisk dhe me të e godet të dëmtuarin M. në pjesën e djathtë të këmbës, duke i' u shkakuar lëndime trupore, të cilat lëndime në bazë të ekspertizës mjeko – ligjore janë kualifikuar si dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet.

Të akuzuarit M. Ll. dhe M. Ll. nga fshati . . . , kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datën 14.09.2021, rreth orës 21:50, në Gjakovë, duke vepruar si bashkëkryerës, tjetrit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtime të përkohshme të shëndetit dhe atë të dëmtuarit A. B., në atë mënyrë që, natën kritike, pas ngjarjes së përshkruar si me lartë, të pandehurit e godasin të dëmtuarin me grushte në pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore si: gërvishje të lëkurës në fytyrë dhe kokë, të cilat lëndime në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore janë kualifikuar si dëmtime të lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti fillestar i incidentit i datës 14.01.2021, Raporti i policit V.R. i datës 15.09.2021, Deklarata e të pandehurit A. B. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 28.06.2024, Deklarata e të pandehurit M. Ll. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 28.06.2024, Deklarata e të pandehurit M. Ll. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 01.07.2024, Raportet mjekësore të lëshura në emër të të pandehurit M. dhe M. Ll., si dhe për të pandehurin A. B., Akt Ekspertimi mjeko-ligjorë i Dr. B. C. i datës 29.06.2022, Fotografitë dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185, paragrafi 1 nën par 1.4 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale Lëndim i lehtë trupor e kryen *“Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”*.

Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *“Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”*.

Ndërsa në nenin 31 të KPRK-së është parashikuar Bashkëkryeja si një nga format e bashkpunimit në kryerjen e veprës penale ne te cilen citohet se *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”*

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, gjyqtari i çështjes të akuzuarit A. B., M. Ll. dhe M. Ll. i ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 nën par 1.4 të KPRK-së dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së e bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke ju vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin A. B. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij të re, gjendjen ekonomike, pendimin e thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njëri tjetrit dhe sjelljen e tyre korrekte në gjykatë. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlersuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin M. Ll. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e dobët ekonomike dhe faktin se është i papunë, mbajtës i familjes, pendimin e thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njëri tjetrit dhe sjelljen e tyre korrekte në gjykatë. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlersuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin M. Ll. Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij të re, pendimin e thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë dhe kërkim faljen ndaj njëri tjetrit dhe sjelljen e tyre korrekte në

gjykatë. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlersuar peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale për të akuzuarit A. B. dhe M. Ll. është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës për M. L. gjykata e ka marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 4 të KPP-së, pasi i njëjti është përfitues i ndihmës sociale sipas Kartelës së ndihmës sociale me numër 486 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë dhe faktin se është mbajtës i familjes andaj duke marrë parasysh këtë fakt konsiderojmë se pagesa e këtyre shpenzimeve do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit.

8. Kërkesa pasurore – juridike

I dëmtuari M. Ll. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 par.2 të KPPK-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë andaj gjykata nuk mund të merr vendim lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2024:181811, më datë 27.11.2024

Zyrtari Ligjor
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.